

VENDIM
Nr. 658, datë 10.10.2019

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 409, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NGUSHTIMIN E DIFERENCAVE NË MASËN E
PENSIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 409, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.1, si më poshtë vijon:

“2.1 Pensionet suplementare, të caktuara sipas dispozitave të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të rillogaritura sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 29, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të sipërshënuar, do të indeksohen dhe masa e pensionit suplementar të vihet në kufirin deri në 50% të masës së pensionit të caktuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

2. Efekti financiar vjetor nga zbatimi i këtij vendimi llogaritet në shumën 26 milionë lekë. Për vitin 2019, efekti financiar llogaritet në shumën 13 milionë lekë dhe do të përballohet nga fondet e parashikuara në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të këtij viti.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që, brenda 30 ditëve, nga data e hyrjes në fuqi, të nxjerrë udhëzimin teknik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe